

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në botë

Gjendja me COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 14-20.10.2024

Janë testuar gjithsej 259 materiale në Laboratorët ku bëhen analiza molekulare për vërtetimin e pranisë së virusit SARS-CoV-2. Krahasuar me javën që shkoi (n=198) është shënuar një rritje prej 30,8%.

Pozitive janë 15 raste, me një rritje të numrit nga java e kaluar për 25,0%. Përqindja e rasteve pozitive sillet nga 0,0% deri më 9,8%, mesatarisht 5,1%.

Tabela 1. Numri i testimeve dhe rasteve pozitive në periudhën nga 14-20.10.2024

Data	Testime	Pozitive	% e rasteve pozitive
14.10.2024	64	3	4,7%
15.10.2024	48	3	6,3%
16.10.2024	41	4	9,8%
17.10.2024	44	2	4,5%
18.10.2024	41	2	4,9%
19.10.2024	17	1	5,9%
20.10.2024	4	0	0,0%
Gjithsej	259	15	mesatarja 5,1%

Gjatë javës së kaluar raste janë regjistruar në 3 qytete. Numri më i madh është regjistruar në Shkup (n=9; 60,0%), ndërsa incidencë më e lartë në Ohër (9,1/100.000). (Tabela 2).

Raste të reja janë regjistruar tek grupmoshat mbi 20 vjet, ndërsa numri më i madh i përket grupmoshës mbi 60 vjet (n=5; 33,3%).

Sipas algoritmit të ri, si të shëruar konsiderohen 24 persona që kanë qenë të shtruar në spital ose në trajtim shtëpiak.

Gjatë javës së kaluar (14-20.10.2024), është raportuar një rast i vdekjes si pasojë e COVID-19, nga Kumanova, në moshë mbi 60 vjet, i pa vaksinuar dhe me komorbiditete, e që ka ndërruar jetë në kushte shtëpiake.

GJENDJA KUMULATIVE ME COVID-19 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Gjatë vitit 2024, deri më 20.10.2024, janë regjistruar gjithsej 1.716 raste me COVID-19. Në muajin shtator të vitit 2024 (288) regjistrohet një rënie prej 65,3% për dallim nga një muaj më parë.

Gjatë vitit 2024, deri më 20.10.2024, janë testuar gjithsej 11.802 materiale, në laboratorët në të cilët realizohen testime molekulare për prani të SARS-CoV-2 dhe në laboratorët / institucionet shëndetësore në të cilat bëhen testimet e shpejta antigjene.

VLERËSIMI I RREZIKUT

Pas një periudhe aktiviteti shumë të ulët, detektohet një rritje e aktivitetit të SARS-CoV-2 brenda kontinentit evropian, përfshirë edhe në R. e Maqedonisë së Veriut.

Personat mbi 60 vjet janë më të rrezikuar nga pasqyra e rëndë e sëmundjes.

Hospitalizimi i personave me COVID-19 të konfirmuar, pranimet në kujdesin intensiv dhe vdekjet mbeten në nivel të ulët në vendet e BE-së. Këto të dhëna nuk janë të disponueshme në R. e Maqedonisë së Veriut.

Rritja e aktivitetit SARS-CoV-2 e thekson nevojën e vazhdueshme për mbikëqyrje (epidemiologjike dhe virologjike) në nivel kombëtar dhe rajonal.

Masa të rekomanduara për parandalim dhe kontroll

Rekomandohet ndjekja e masave themelore për parandalimin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera respiratore.

Vaksinimi mbetet si masë specifike që mundëson mbrojtje nga format e rënda të sëmundjes, edhe pse ky efekt mbrojtës me kalimin e kohës dobësohet. Mbetet rekomandimi për vaksinimin e personave me rrezik të lartë nga format e rënda të sëmundjes (siç janë personat më të moshuar).¹

Shkup, 21.10.2024

Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse

Instituti i Shëndetit Publik

¹ <https://www.ecdc.europa.eu/sites/default/files/documents/2024-WCP-0039%20Final.pdf>